

**UNIVERSITETI I MITROVICËS
“ISA BOLETINI”**



ZYRA PËR SIGURIM TË CILËSISË

**Raport përmbledhës për
vetëvlerësimin e stafit
akademik.**

(Semestri veror)


Gusht, 2020

Përmbajtja

Lista e shkurtesave	3
Hyrja	4
Zyra për Sigurim të Cilësisë	5
Realizimi i pyetësorit	5
Gjetjet e pyetësorit	6
1. Mësimdhënia	8
2. Raportet me studentët	16
3. Zhvillimi profesional	18
4. Mbajtja e të dhënave	21
5. Përparësitë e stafit akademik	22
6. Nevoja për përmirësim	26
Rekomandimet	31

Lista e shkurtesave

IAL:	Institucion i Arsimit të Lartë
KQSCV:	Komisioni Qendror për Sigurimin e Cilësisë dhe Vlerësimin
SEVC:	Sistemi Elektronik për Vlerësimin e Cilësisë
SMU:	Sistemi i Menaxhimit Universitarë
UMIB:	Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini”
ZSC:	Zyra për Sigurim të Cilësisë



Hyrja

Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” (këtu e tutje: UMIB), si Institucion i Arsimit të Lartë (Këtu e tutje: IAL) themeluar që nga viti 2013, vazhdimisht ka bërë përpjekje që të bëjë të matshëm procesin e sigurimit të cilësisë. Për çdo vit, në UMIB janë organizuar pyetësorë me studentët dhe akterë tjerë relevant, të cilët janë përgjigjur në pyetjet të cilat kanë pasur për qëllim të tregojnë gjendjen reale në UMIB përmes perceptimit të respondentëve.

UMIB ka mekanizmat e tij për matjen e cilësisë, dhe përveç që procesi matet dhe monitorohet në vazhdimësi nga ana e dekanëve, prodekanëve, koordinatorëve për cilësi në kuadër të fakulteteve, Zyra për Sigurim të Cilësisë në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini” (Këtu e tutje: ZSC) ka një rol të veçantë në këto zhvillime, dhe është organi kryesor brenda UMIB për matjen e cilësisë së brendshme.

Në muajin Qershor dhe Korrik 2020, në vazhden e aktiviteteve për të përmirësuar cilësinë brenda UMIB, me qëllim të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve në UMIB, përmirësimit të mësimdhënies si një proces vazhdimisht i ndryshueshëm përkitazi me metodologjitë e reja, dhe rritjes së përgjegjësisë së stafit menaxhues, ZSC-ja ka realizuar pyetësorin për vetëvlerësimin e stafit akademik në UMIB, si një proces tashmë i zakonshëm.

I gjithë procesi i lansimit të pyetësorëve dhe i mbledhjes së të dhënave është bërë nga ZCS-ja në koordinim të plotë me KQSCV-në. Procesi ka qenë transparent duke respektuar kështu dinjitetin e secilit respondent dhe duke ruajtur prestigjin e institucionit.

Më poshtë, do të paraqesim të dhënat që janë nxjerrë nga pyetësori. Me qëllim që raporti të ruaj etikën e secilit dhe atë të institucionit, do të gjeni të publikuara vetëm disa nga gjetjet kryesore të pyetësorit. Rekomandimet si pjesa e fundit e tij, do të përmbajnë edhe sugjerime e vërejtje të cilat nuk bëhen publike, por që janë dhënë nga ana e respondentëve.

Zyra për Sigurim të Cilësisë (ZSC)

Zyra për Sigurim të Cilësisë është zyrë e pavarur e cila funksionon brenda Rektoratit të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” (tutje UMIB) e cila raporton drejtpërdrejt te Rektori i UMIB-it. ZSC angazhohet në rritjen e cilësisë në UMIB duke zbatuar të gjitha politikat institucionale dhe instrumentat matës të cilësisë të aprovuar nga Komisioni Qendror për Sigurimin e Cilësisë dhe Vlerësimit (tutje KQSCV). Zyrtarët e cilësisë nuk janë pjesë e stafit akademik të UMIB-it. Zyra kryen matje të cilësisë duke përdorur të gjitha instrumentet e përfshira në pakon e instrumenteve matëse të cilësisë e aprovuar nga KQSCV. ZSC harton raporte që përmbajnë gjetje dhe rekomandime për secilën pyetësor të realizuar të cilët i dërgon te Rektori i UMIB-it. Zyra gjithashtu i dërgon gjetjet dekanëve të njësive akademike me qëllim të planifikimit të zhvillimit të stafit akademik dhe përmirësimit të vazhdueshëm.



Realizimi i pyetësorit

Vetëvlerësimi i stafit akademik është një proces i cili realizohet 2 herë brenda vitit akademik në përfundim të çdo semestri. KQSCV ka aprovuar pyetësorin për vetëvlerësimin e stafit akademik dhe ZSC me datë 29.06.2020 deri me 09.07.2020 ka lansuar pyetësorin për vetëvlerësim përmes koordinatorëve për cilësi në njësitë akademike tek stafi akademik.

Pyetësori ka qenë i destinuar për të gjithë profesorët dhe asistentët që kanë pasur lëndë aktive në semestrin veror 2020. Të dhënat e mbledhura janë sistemuar nga ZSC-ja dhe janë dërguar tek dekanët e njësive akademike si dhe tek menaxhmenti qendror i UMIB-it. Stafi Akademik është përgjegjës përmes Google Forms në pyetësorin i cili ka përmbajtur 26 pyetjet të mbyllura dhe 2 pyetje të hapura ku janë kërkuar përpjesëtimet dhe nevojat për përmirësim.

Pyetësori ka qenë i ndarë në 4 nivele:

- Mësimdhënia
- Raportet me studentët
- Zhvillimi profesional
- Mbajtja e të dhënave

Pyetjet kanë pasur për qëllim që të shohin këto aspekte kryesore:

- Qasjen e mësimdhënësve ndaj studentëve;
- Zbatimi i plotë i syllabusit
- Metodatat e mbajtjes së mësimin online;
- Hapësirën e studentëve gjatë orës mësimore;
- Sjelljen e mësimdhënësve;
- Raportet me studentët
- Zhvillimi profesional
- Mbajtja e të dhënave
- Përpjesëtimet e mësimdhënësve dhe
- Nevojat për përmirësim

Gjetjet e pyetësorit

ZSC ka shpërndarë pyetësorin tek stafi akademik përmes koordinatoreve për cilësi nga data 20.06.2020 deri me 09.07.2020 dhe kemi marrë gjithsej 69 vetëvlerësime të stafit akademik.

Ky raport shprehë vetëm statistikën e përgjithshme, dhe rekomandimet që dalin nga tërësia e përgjigjeve janë nxjerrë nga të dhënat nga pyetësorët. Paraqitja e të dhënave nuk pasqyron opinionin e ZSC-së por pasqyron gjendjen e nxjerrë nga të dhëna e mbledhura nga pyetësorët.

Raportet për profesorët veç e veç, ZSC-ja i ka dërguar tek Dekanët e fakulteteve, dhe ata do t'i diskutojnë gjetjet me stafin akademik nga ku Dekanët do të bëjnë vlerësimin e stafit akademik.

Numri i stafit akademik që ka bërë vetëvlerësimin është 69, nga ta 47 profesor dhe 22 asistentë.




Fig.1. Numri i stafit akademik që kanë bërë vetëvlerësimin sipas angazhimit.

Nga 69 vetëvlerësime, 22 janë në Fakultetin e Gjeoshkencave, 15 janë në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore, 11 janë në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike, 7 janë në Fakultetin Juridik, 5 janë në Fakultetin Ekonomik dhe 9 janë në Fakultetin e Edukimit.




Fig.2. Numri i stafit akademik që kanë bërë vetëvlerësimin nga secila njësi akademike.

1. Mësimdhënia

Pjesa e parë e pyetësorit ka qenë e fokusuar tek mësimdhënia.

Stafi akademik kanë deklaruar që kanë mbajtur rregullisht ligjërata dhe ushtrimet, 62% e tyre deklarojnë që nuk kanë pasur problem me qasjen online në ligjërata dhe me evidentimin e studentëve në klasën virtuale. Stafi akademik ka shpërndarë me kohë syllabusin e lëndës dhe ka sqaruar përmbajtjen, vlerësimin dhe detyrat. Kanë realizuar me sukses temat e syllabusit duke shfrytëzuar platformën online. Gjatë ligjëratave stafi akademik kanë përdorur ndihmën e tabelave, posterave etj, për të treguar shembuj-raste nga praktika në mënyrë që studentët ta kuptojnë më mire ligjëratën/ushtrimet. Stafi akademik I ka inkurajuar dhe u ka mundësuar studentëve të bëjnë pyetje dhe komente në çdo kohë gjatë ligjëratave. Vërejtjet dhe sugjerimet e studentëve janë marrë në konsideratë nga stafi akademik dhe ato vërejtje i kanë pasqyruar.




Fig.3. Përgjigja e pyetjes: Unë kam mbajtur rregullisht ligjëratat/ushtrimet online.




Fig.4. Përgjigja: Kam pasur probleme me qasjen online në ligjërata.




Fig.5. Përgjigja: Kam pasur probleme me evidentimin e studentëve në klasën virtuale nga SMU.




Fig.6. Përgjigja: Gjatë kohës së Covid 19 e kam realizuar pa asnjë problem temat e syllabusit.




Fig.7. Përgjigja: Unë kam arritur të shfrytëzoj mirë platformën e mësimit online me studentët.



Fig.8. Përgjigja: Unë kam shpërndarë me kohë syllabusin e lëndës.




Fig.9. Përgjigja: Në ligjëratën e parë kam sqaruar përmbajtjen, vlerësimin, detyrat etj.




Fig.10. Përgjigja: Unë kam përdorë shembuj- raste nga praktika me qëllim që studenti ta kuptoj më mirë ligjëratën/ushtrimet




Fig.11. Përgjigja: Unë kam përdorë ndihmën e tabelave, teknologjisë, postereve e të ngjashme.




Fig.12. Përgjigja: Unë kam përdorë mundësitë teknike të cilat i ka ofruar mësimi online për ti shfaqur gjatë ligjërimit/ushtrimeve.




Fig.13. Përgjigja: Unë lejoj studentët që të bëjnë pyetje dhe komente në çdo kohë gjatë ligjëratis.




Fig.14. Përgjigja: Unë përdorë aktivitete të cilat shtynë studentët të jenë aktiv në ligjëratis.




Fig.15. Përgjigja: Vërejtjet dhe sugjerimet e studentëve për ndryshime në syllabus i kam marrë parasysh.




Fig.16. Përgjigja: Unë kam shpërndarë me kohë planin e ushtrimeve laboratorike, detyrave, rasteve studimore, testeve dhe kuizeve.




Fig.17. Përgjigja: Unë i kam përfshirë hulumtimet e mia në përmbajtjen e syllabusit.

2. Raportet me studentët

Pjesa e dytë e pyetësorit ka qenë e fokusuar tek raportet e stafit akademik me studentët.

Qasja e stafit akademik me studentët ka qenë në rregull dhe gjithmonë korrekte. Stafi akademik deklaron që studentët here pas here kanë pasur probleme me qasjen në ligjërata. Studentët janë vlerësuar për secilin aktivitet të tyre gjatë ligjëratave/ushtrimeve dhe janë marrë parasysh në vlerësimin përfundimtar.

16. Qasja ime me studentët ka qenë gjithmonë korrekte.




Fig.18. Përgjigja: Qasja ime me studentët ka qenë gjithmonë korrekte

17. Studentet kane pasur probleme me qasjen online ne ligjërata.




Fig.19. Përgjigja: Studentet kane pasur probleme me qasjen online ne ligjërata.




Fig.20. Përgjigja: Unë kam respektuar Statutin dhe Rregulloren e studimeve të UMIB në vlerësimin e studentëve




Fig.21. Përgjigja: Kontributin e studentit nga secili aktivitet gjatë semestrit e përfshij në vlerësimin përfundimtar?

3. Zhvillimi profesional

Pjesa e tretë e pyetësorit ka qenë e fokusuar tek zhvillimi profesional i stafit akademik.

Zyra e IT ju ka dale në ndihmë stafit akademik për të ju lehtësuar qasjen dhe eliminuar vështirësitë e shfrytëzimit të platformës online. Stafi akademikë kanë marrë pjesë në trajnime për metodat e reja të mësimdhënies por kjo pjesë duhet të fuqizohet edhe më tepër si dhe stafi akademik vazhdimisht angazhohen të përmirësojnë aftësitë në gjuhët e huaja.




Fig.22. Përgjigja: Unë kam bashkëpunuar me kolegët dhe me zyrën e IT-së për të eliminuar vështirësitë e shfrytëzimit të platformës online.




Fig.23. Përgjigja: Bashkëpunoj me kolegët tjerë për të identifikuar dhe zgjidhur problemet e mësimit dhe të fakultetit.




Fig.24. Përgjigja: Kam marrë pjesë në trajnime për metoda të reja të mësimit.




Fig.25. Përgjigja: Unë vazhdimisht përmirësoj aftësitë në gjuhë të huaja.

4. Mbajtja e të dhënave

Pjesa e katërt e pyetësorit ka qenë e fokusuar tek mbajtja e të dhënave nga stafi akademik. Stafi akademik mbamë vazhdimisht shënime për aktivitetet e studentëve dhe përditëson në vazhdimësi planin e tyre të ligjëratave/ushtrimeve dhe shënimet janë në dispozicion në çdo kohë për menaxhmentin nëse kërkohen.




Fig.26. Përgjigja: Unë gjithmonë përditësoj planin tim të ligjërimit/ushtrimeve.



Fig.27. Përgjigja: Jam në gjendje që këto shënime ti ofroj në çdo kohë tek menaxhmenti nëse kërkohen




Fig.28. Përgjigja: Unë mbajë shënime për angazhimin e studentëve për të gjeturat nga rastet kërkimore, rezultatet e punës laboratorike dhe mbi përfundimet e referateve nga vizitat e tyre studimore, të cilat përfshihen në vlerësimin përfundimtar.

5. Përparësitë e stafit akademik

Pjesa e pestë e pyetësorit ka qenë e fokusuar tek përparësitë e stafit akademik.¹

- Jam shumë e afërt me studentë dhe mundohem të ju ndihmoj në çdo aspekt.
- përvoja në mësimdhënie
- I përshtatem ndryshimeve të nevojshme në kuadër të njësisë.
- Mësim, punë, bashkëpunim, korrektësi dhe zhvillim.
- Përvoja e gjatë(33 vjeçare) në mësimdhënie. Bartës i lëndëve mësimore të fushës sime të ngushtë të studimeve.
- I afërt me studentet dhe i pranojmë vërejtjet dhe sugjerimet e tyre.
- Metodologjia e ligjëratave e unifikuar me ato përëndimorë, meqë kam mbaruar studimet pasdiplomike dhe të doktoratës në shtetet e BE-se.
- Respektim i orarit, gatishmëria e bashkëpunimit të hapur me studentet dhe koleget, përvoja shkencore dhe profesionale, mbajtja e informuar me trendet shkencore të fushës
- Gjuha angleze, aftësi hulumtuese dhe shpjeguese
- Bashkëpunuese me koleget dhe studentet, korrekte, kërkuese...
- Aftësia e komunikimit
- Ofroj gjithmonë një mjedis motivues për studentet e lëndes.
- Çasja ime me studentet, gatishmëria për bashkëpunim me stafin, gatishmëria për përmirësim të vazhdueshëm.
- Gjithmonë tentoj të mbaj aktive klasën.
- Përvoja e gjatë në jetën akademike dhe profesionale (praktike) dhe gërshetimi i tyre gjatë jetës akademike në raport me studentët gjatë ligjërimit.
- Bashkëpunim me koleget, studentet dhe menaxhmentin në fushën profesionale dhe projektet zhvillimore akademike në të mirë të gjithëve
- Njohurit praktike, dhe njohja e software-ve të veçanta për punë praktike.
- Punimi im i doktoratës, ai i magistraturës dhe shumica e punimeve të mia shkencore dhe profesionale i përkasin fushave të lëndëve mësimore në të cilat i mbajë ligjëratat.
- Respektimi rigoroz i Statutit dhe Rregulloreve të UMIB-it.
- I afërt me student me qëllim të realizimit sa më të mirë të syllabusit

¹ Përgjigjet në kapitullin 5 janë vendosur ashtu siç janë marrë nga stafi akademik.

- Sa i përket lëndës së Gjeokimisë, edhe pse mësimdhënia deri në muajin qershor është zhvilluar përmes mësimit online, bashkëpunimi dhe komunikimi interaktiv me studentët si dhe thellimi në kuptim më të thellë logjik për të rritur aftësinë dhe shkathtësinë në mësimnxënie, me qëllim të motivimit dhe nxitjes së studentëve për kërkimin shkencorë, ka përmbushur strategjinë e mësimdhënies, të paraparë me Syllabus. Për këtë u jam falënderuese dhe mirënjohëse studentëve për pjesëmarrje aktive dhe motivuese, e në veçanti më ka mahnitur kultura e tyre etike dhe dëshira për tu bërë kërkues të rinj të mirëfilltë shkencorë.
- Jam i rregullt dhe korrekt.
- Eksperienca e gjatë në procesin arsimor dhe përgatitja profesionale - Eksperienca të gjatë në mësimdhënie, mësimdhënës në fushën time të studimit, mbajtja e mësimit (ligjërata, ushtrime/lab/terren) gjithmonë me kohë; - Korrektësia, transparenca ndaj kërkesave të studenteve dhe sjellja e shkëlqyer me ta; - Vlerësimi korrekt për secilin student; - Përdorimi i teknologjisë së avancuar në mësimdhënie.
- Përgatitja e deritanishme, pasioni dhe përkushtimi.
- Vazhdimisht merrem me hulumtime (punë) shkencore në zgjidhjen edhe trajtimin e problemeve minerare duke përfshirë minierat sipërfaqësore dhe ato nëntokësore. Studentëve gjithherë ju ofrohet njohuri e lartë shkencore, bashkërisht studiojmë fushat e caktuara minerare në përputhje me syllabusat e lëndëve.
- Me kohë mbajë ligjëratat dhe konsultimet
- Kam përgatitje adekuate dhe komunikim të afërt me studentet dhe kolegët
- Përgatitja në nivel të duhur si dhe eksperienca shumëvjeçare në arsimin e lartë
- Posedoj njohuri në TI, Informohet rreth risitë në fushën e financave, i përcjelli trendet e zhvillimit etj.
- Vazhdimisht bëjë përpjekje që angazhimi im të jete maksimal në shërbim të studenteve
- Shkathtësi dhe vullnet për të punuar duke respektuar principin e paanësisë dhe objektivitetin, Vullnet për të punuar në kushte sfiduese, Përvojë dhe shkathtësi për të punuar nën presion dhe në kohë të ndryshme, Bashkëpunues me studentët në çdo kohe.
- Njohuri të mira në fushën e teknologjisë informative
- Shpjegim i qartë për studentet dhe lidhja me situatën.
- Qasja proaktive, komunikimi dhe bashkëpunimi, përditësimi i ligjëratave, interaktiviteti, përcjellja e zhvillimeve globale të ndërlidhura me minierat, energjinë dhe mjedisin ,bashkëpunimet ndërkombëtare dhe pjesëmarrja në forumet ndërkombëtare!

- Posedoj përvojën praktike nga fusha e mësimdhënies, shfrytëzoj literaturën më të përshtatshme për mësimdhënie/student (nga gjuhët e huaja: angleze dhe gjermane).
- Besoj që gjatë këti semestri përmes sistemit online kam arritur në çdo kohë me ju ndihmua studenteve në nevojat e tyre gjatë ushtrimeve, seminare apo angazhimet e ndryshme që i kanë pasur në këtë periudhë
- Angazhimi
- Duke qenë asistent si pjesë akademike e Fakultetit të Gjeoshkencave-Universiteti i Mitrovicës dhe në njëkohësisht si student i doktoratës nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Inxhinierisë-Universiteti i Lubjanës jam pajisur me njohuri dhe kualifikime të mëdha. Sidoqoftë, mundësia për të vazhduar punën time dhe studime jashtë vendit ka zgjeruar njohuritë e mia dhe ka siguruar përparim të mëtejshëm. Kjo ka qenë shumë e dobishme sepse bëri të kuptoj rëndësinë e fushës time të Materialeve dhe Metalurgjisë. Përveç studimeve të mia, kam marrë pjesë edhe në aktivitete të ndryshme jashtëshkollore, në mënyrë që të fitoj më shumë përvojë dhe kompetencë. Duke qenë student i doktoratës si pjesë e Universitetit të Lubjanës, kam pasur kënaqësinë të punoj dhe të bashkëveproj me njerëz të larmishëm të Universiteteve Evropiane, gjë që më ka bërë me mendje të hapur dhe më të vetëdijshëm për shumë gjëra që duhet të mësohen në të ardhmen, gjithashtu kjo ka qenë një përvojë e re që më ka siguruar aftësitë e duhura në fushën e metaleve, të tilla si, hulumtimi, udhëheqja dhe komunikimi. Për më tepër, unë u përfshiva gjithashtu si pjesëmarrës në seminare dhe konferenca të ndryshme në vendet Evropiane si: Austri, Slloveni, Gjermani, Kroaci ku fitova një përvojë profesionalizmi dhe përgjegjësie, e cili ishte shumë e dobishëm për të ardhmen time në fushën metaleve duke punuar në grupe, si në punë ashtu edhe në projekte hulumtuese.
- Adaptimi në situata të reja
- Mendoj se përpirësit e mia janë që vazhdimisht kam bërë përpjekje që për të gjithë studentet të krijoj ndjenjën e përfshirjes në klase dhe mësimi të jetë sa më instruktiv, bashkëpunimi me koleget, etj.
- Komunikativ, transparent, i përkushtuar, korrekt ...
- Aftësitë komunikuese, menaxhim i suksesshëm i grupeve pavarësisht numrit, përcjellje e njohurive tek studentet në mënyrë kualitative, motivim i studenteve etj.
- Shpjegimin e problemeve në qasje me moderne

- Rifreskimi i përmbajtjeve të ligjëratave me zhvillimet e fundit; angazhimi i studenteve; komunikimi i hapur dhe qasja interaktive; sqarimi i obligimeve dhe afateve; mësimdhënia interaktive
- Përvoja, Njohurit e deritanishme, Motivimi, Përkushtimi etj.
- Jam e afërt me studenta dhe gjithmonë e gatshme t'u përgjigjem nevojave dhe kërkesave të tyre, si dhe bashkëpunëtorë me koleget e mi.
- Bashkëpunues
- Aftësi për të ndërlidhur mësimin teorik me punën praktike
- Komunikuese, aftësi për të shpjeguar temat e vështira në mënyrë me te thjeshte, entuziaste
- Përvoja dhe angazhimi ne kohe te gjate ne mësimdhënie.
- Përvojë ne pune profesionale.
- Kam komunikim dhe afërsi ne bindjen e studenteve drejt rritjes se vullnetit për mësim nxënie dhe e vlerësojnë këtë sidomos ne pjesën praktike apo ne hulumtime profesionale.
- Përvoja e gjate ne akademi dhe ne industri.
- qasje e lire studenteve ne diskutim, ligjërata atraktive.
- Angazhimi permanent në punën me studentë, gjatë ligjëratave, ushtrimeve, konsultimeve, udhëheqjes së punimeve të diplomave të dy niveleve, etj.
- Një eksperience e re dhe shume e nevojshme edhe për situata tjera të kohës
- Provoja shumëvjeçare
- Vlerësimi nga ana e studenteve për mbajtjen e orës mësimore .
- Njohja e mire e teknologjisë dhe gjuhëve te huaja. Përdorimi i teknologjisë ne klase dhe gjate mësimin virtual për zhvillimin e ligjëratave.
- Përfundimi i studimeve te doktoratës në një program double degree të Tempusit ku për çdo lëndë kemi pasur dy profesorë (një të Universiteteve Evropiane dhe një të vendeve të Ballkanit), hulumtimet e ndryshme, takimi me kolege te kulturave te ndryshme, përvoja e mobilitetit si dhe ngritja e nivelit te aftësive dhe njohurive te mia duke bashkëpunuar me mentoren time shume te respektuar nga Universiteti i Nices Cote D'Azur besoj se përbejnë një pjese te rëndësishme te përparësive e mia.
- I hapur për diskutime.
- Gjatë punës time mundohem gjithmonë që pjesa teorike të realizohet me praktike. Duke i dërguar studentet në kompani prodhuese të natyrës së lëndës që e ligjëroj.
- Jam bashkëpunuese, transparente, dhe gjithmonë e gatshme të punojë në grup!

- Komunikues dhe bashkëpunues me kolegët dhe studentët për çështjet akademike. I përkushtuar në mësimdhënie, korrekt në raport me studentët dhe kolegët, i nxitur për zhvillimin e vazhdueshëm profesional.
- Praktikimi i metodave bashkëkohore për mësim-nxënie

6. Nevoja për përmirësim:

Pjesa e gjashtë e pyetësorit ka qenë e fokusuar tek nevojat për përmirësim të stafit akademik.²

- Kam nevojë ta përmirësoj gjuhën angleze.
- është e vazhdueshme për t'iu përshtatur nevojave dhe kërkesave që paraqiten
- Ne publikime shkencore
- Përmirësimi i kushteve teknike dhe akademike për student dhe për pedagog
- Përmirësimi i aftësive në gjuhë të huaja si dhe rritja e numrit të publikimeve shkencore.
- Ndarja ne grupe hulumtuese dhe definimi i qarte i problematikes hulumtuese te secilit grup
- Shkrimi i librave të mi për lëndët që i mbajë.
- Avancimi i metodave pedagogjike në mësimdhënie, avancim në metodologjinë e mësimdhënies.
- Analiza statistikore e avancuar, trajnime për metodat e avancuara të mësimdhënies
- Trajnime për metoda te reja te mësimdhënies dhe trajnime (kurse) për te avancuar gjuhet e huaja
- Te mos flas shume shpejte!
- Kam një tendence të jam shume kritik ndaj punës sime të mësimdhënies para studenteve, dhe prandaj shpenzoj tepër shume kohë me punët e përgatitjes se ligjëratave.
- Kyçja me e madhe ne projekte hulumtuese me kolege tjerë brenda dhe jashtë UMIB, kyçja ne projekte te ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Çdo herë ka nevojë për përmirësime.
- Avancimi i mëtejme në përvetësimin e disa gjuhëve të huaja.
Trajnim në mësimdhënie me teknologjitë e reja
- Trajnime për mësimdhënie.

² Përgjigjet në kapitullin 6 janë vendosur ashtu siç janë marrë nga stafi akademik.

- Përmirësimi i aftësive në gjuhë të huaja dhe rritja e numrit të publikimeve shkencore.
- Vëmendje më e madhe publikimit të punimeve shkencore hulumtuese.
- Nevoja për furnizim me pajisje laboratorike me qëllim të realizimit sa më të mirë të ushtrimeve.
- Në formularin e vetëvlerësimit më 12.02.2020, kam paraqitur nevojat për përmirësim lidhur me strategjinë e veprimtarisë kërkimore - shkencore në Fakultetin e Gjeoshkencave, si nevoja të domosdoshme në nxitjen e politikave të kërkimit shkencorë dhe mekanizmave motivues për përmasimin e kualitetit mësimor dhe aftësimin e mësimdhënësve dhe studentëve në nivel të standardeve evropiane.
- Vërejtje: Mendoj që platforma e mësimin, natyrisht sipas mundësive të shërbimit informativ
- në sistemin online, mund të avancohet për të plotësuar objektivat e qarta të
- kërkimit shkencorë dhe inovacionit, duke lehtësuar kështu detyrat dhe përgjegjësitë
- e stafit akademik.
- Vizita neper Institucione dhe fabrika
- Perfeksionimi i gjuhëve të huaja .
- Gjithmonë ka nevojë për përmirësim, dhe vazhdimisht duhet të angazhohemi për avansim në cilësinë e mësimdhënies dhe gjithashtu duke ndjekur trendin zhvillimor të teknologjisë me vendet e rajonit por edhe më gjerë.
- Përmirësimi i aftësive në gjuhë të huaja.
- Me avancimin e teknologjisë dhe trendit botëror në fushën e minierave paraqitet nevoja për përmasime dhe plotësime me risi të reja shkencore, aplikimi i softwarve kompjuterike është i domosdoshëm në rritjen e nivelit të mësimdhënies dhe mësim-nxënies.
- T'i përditësoj njohurit e reja
- Gjate gjithë jetës kemi nevojë për avancime dhe përmirësime.
- Avancim në metodat bashkëkohore të mësimdhënies
- Pajisja me softweret aplikativ ekonometrike, dhe të financave si dhe krijimi i username në Turnitin për publikime.
- Në profesionin e ligjërimit vazhdimisht duhet të jesh fleksibil.
- Ngritja e nivelit të avancimit me metodat bashkëkohore,
- Ngritja e kapaciteteve shkencore,
- Ngritja e metodologjisë së mësimdhënies.
- Përmirësim të gjuhës angleze
- Përditësimi i të rejave të fundit

- Ngritja e aftësive ne përdorim dhe zbatim te metodave bashkëkohore të mësimdhënies.
- Përfshirja e studenteve ne projekte kërkimore.
- Hulumtimi dhe avancimi i metodave të reja gjatë ligjërimit dhe ushtrimeve, trajnime , konferenca te ndryshme qe do na ndihmoni në përmirësim
- Metodologjitë e mësimdhënies
- Është thënë se rruga drejt suksesit udhëhiqet përmes studimeve, bibliotekës, hulumtimit, Kjo deklaratë është e vërtetë. Pa libra, revista, hulumtim dhe informacione, nuk mund të ketë ndonjë punë me vlerë profesionale ose ndonjë kërkim të mirë, mësimdhënie apo hulumtime. Kështu, nevoja për të sjell njohurit e reja kërkohet studim dhe hulumtim i pandërprerë dhe i detajuar me një frymë novatore dhe sipërmarrëse të kërkuar sipas nevoja dhe kërkesave në fushën e Metaleve.
- Ne metoda te reja te mësimdhënies
- Përmirësimi i kushteve te punës ne mënyrë qe te lehtësohet mësimdhënia po ashtu dhe mësim- nxenia, duke sjelle pajisje te cilat lehtësojnë realizimin e punës praktike ne FGJ.
- Zhvillim i vazhdueshëm profesional ...
- Përfshirja me e shpeshte ne trajnime.
- Kërkohet
- Trajnimet e avancuara për mësimdhënie ne arsimin e larte; Aftësitë e shkrimit te projekteve te BE
- Kompletimi i laboratorëve me pajisje të reja.
- Trajnime ne metodat dhe teknikat me te reja te mësimdhënies.
- Në përdorimin e programeve te ndryshe kompjuterike
- Trajnime për metoda të reja të mësimdhënies
- Gjithmonë dhe çdokush ka nevojë për përmirësim në çdo fushe.
- Aktivitetet me te mëdha në fushën e hulumtimit.
- Ndjekja e praktikave te avancuara ne mësimdhënie.
- Me kalimin e kohës arrihet çdo përmirësim qe shfaqet ne pune. Ata qe punojnë gabojnë dhe kërkojnë mbështetje për përmirësime ne proceset e punës.
- Furnizimi i kabineteve tona me pajisje te teknologjisë se fundit.
- infrastruktura laboratorike te kompletohet dhe te jete funksionale për pune praktike
- Krijimi i Institutit për hulumtime shkencore në kuadër të FTU-së, si dhe përfshirja më e madhe e profesorëve dhe e studentëve në punë hulumtuuese-shkencore.

- Të ketë më shumë trajnime në metodat e reja të mësimdhënies, trajnime profesionale, trajnime që kanë të bëjnë me mësimin online si dhe përdorimin e disa platformave në kuadër të SMU-së.
- Të ketë më shumë angazhime lidhur me mundësinë e shkëmbimit të stafit akademik dhe të studentëve në kuadër të projektit Erasmus +, etj.
- Të rritet niveli i bashkëpunimit ndërkombëtar.
- Derisa universiteti obligon mësimdhënien dhe mësim nxënien, fillimisht duhet ti pajis te gjithë mësimdhënësit dhe studentet me pajisje teknologjike (llaptop) për një proces te suksesshëm te mësimi. Jo te gjithë studentet dhe mësimdhënësit kane pajisjet teknologjike personale
- Pajisje laboratorike
- Te na mundësohet qasja ne biblioteka online dhe platforma ndërkombëtare ,do te ishte me se e mirëseardhur ,si dhe trajnime ne fusha te ndryshme qe mbështesin punën akademike .
- Gjatë mësimdhënies mendoj se duhet përdorimi i me shumë metodave bashkëkohore për angazhimin e studenteve ne klase.
- Njerëzit e mençur asnjëherë nuk ngopen duke mësuar, prandaj, edukimi i vazhdueshëm është pjese përbërëse e procesit për përmirësim te vazhdueshëm.
- Procesi mësimor është ne nivel.
- Me zhvillimet e teknologjisë dhe jetës ne përgjithësi gjithmonë kemi nevojë për përmirësim.
- Hulumtimet -puna shkencore janë dhe do jene gjithmonë pjese e punës time akademike, ne zhvillimin e profesionit time.
- Mbajtja e trajnimeve të vazhdueshme!
- Të kuptuarit me kohë dhe drejt të metodologjive të reja për kërkimin shkencor sipas kërkesave të kohës si dhe përdorimin e teknologjisë së ofruar nga Universiteti, të dobishme për mësimdhënie dhe mësim-nxënie akademike.
- Aplikimi i gjuhëve programuese

Rekomandimet

Zyra e cilësisë e UMIB, pasi që ka shqyrtuar përgjigjet e vetëvlerësimit të stafit akademik, dhe pas analizës së të gjitha pyetjeve dhe komenteve, në këtë fazë të zhvillimit të institucionit, i rekomandon menaxhmentit të lartë të UMIB që të merren hapat si më poshtë:

- Ofrimi i kurseve të gjuhëve të huaja për stafin akademik
- Përkrahja e stafit akademik në publikime shkencorë brenda dhe jashtë vendit.
- Përkrahja e stafit akademik në botime të librave që mbulojnë lëndët që zhvillohen brenda UMIB.
- Organizimi i trajnimeve për metodat e reja të mësimdhënies
- Nga Qendra për Zhvillim në Karrierë të ofrohen informata dhe mundësi për stafin akademik për mundësitë e publikimeve shkencore.
- Krijimi i rrjetit të stafit akademik brenda UMIB për të ofruar mundësi të bashkëpunimit.
- Avancimi në vazhdimësi i laboratorëve dhe furnizimin me pajisje të reja laboratorike.
- Organizimi i vizitave studimore për stafin akademik dhe studentët.
- Krijimi i Instituteve hulumtuese shkencore në kuadër të njësive akademike